



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Bordi

VENDIM

Nr. 80, datë 31.05.2019

MBI
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY24” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37 pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshur; nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96 datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 31.05.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, lidhur me “Licencimin e shoqërisë “ENERGY 24” sh.p.k, në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike.

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 61, datë 19.04.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k, në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike.
- ERE me shkresën nr. 32/17 Prot., datë 18.04.2019, ka publikuar njoftimin në median e shkruar lidhur me vendimin nr. 61, datë 19.04.2019 mbi “Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k., në veprimtarinë e tregëtimit të energjisë elektrike”
- ERE në shkresën nr. 273/1 Prot., datë 02.05.2019 ka përcjellë pranë subjektit “Energy24” sh.p.k, njoftimin e vendimit të fillimit të procedurës dhe kërkesën për plotësimin e dokumentacionit të munguar.
- Me shkresën me nr. 273/2Prot. Hyrës, datë 14.05.2019 shoqëria “Energy24” sh.p.k ka përcjellë pranë ERE-s, dokumetacionin e munguar sikurse është kërkuar nga ERE.
- Në përfundim të afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Energy 24” sh.p.k, për licencim në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike.
- Nga analiza që i’u bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria “Energy 24” sh.p.k, në bazë të “Rregullores për Procedurat e Licencimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Licensave”, rezulton se subjekti ka plotësuar tërësisht kërkesat, si më poshtë :

- Neni 9, pika 1, gërmat “a”; “b” dhe “c”- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, është plotësuar.
- Neni 9, pika 2, gërmat “a”;“b”;“c”; “d” dhe“e“ -Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, është plotësuar.
- Neni 9, pika 3, gërmat “a”;“b”; “c” dhe“d”- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, është plotësuar.
- Neni 9, pika 4.8, gërmat “a”;“b”; “c” dhe “d”- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, është plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy24” sh.p.k., në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit AHMETI